

MANUAL PËR MËSIMDHËNËSIT DHE BASHKËPUNËTORËT PROFESIONISTË

Mbrojtja e fëmijëve nga trafikimi i qenieve njerëzore Çka duhet të bëjnë shkollat?



Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



МОНИСТРОТСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА - ШКОЛА ЗА ПУЛНО БА ОБРАЗОВАНИЕТО
MINISTRIA E ARSHMIT DHE SHKENCËS-HYRËJA E ZVILLIMIT TË ARSHMIT
MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE-BUREAU FOR DEVELOPMENT OF EDUCATION

MANUAL PËR MËSIMDHËNËSIT DHE BASHKËPUNËTORËT PROFESIONISTË

**Mbrojtja e fëmijëve nga trafikimi i qenieve njerëzore
Çka duhet të bëjnë shkollat?**

*Ky publikim është prodhuar me mbështetjen
financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të
Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të
merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit
zyrtar të secilës palë.*

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500
fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime
tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit,
fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit,
nuk jepen informacione të paplota dhe nuk
e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës,
fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti
burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon
“©Këshilli i Evropës, viti i botimit”.

Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me
riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij
dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij,
duhet t’i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve,
Këshilli i Evropës (F-67075 Strasburg Cedex ose
publishing@coe.int).

Kopertinat dhe dizejni grafik:
Documents and Publications
Production Department

(SPDP), Këshilli i Evropës fotografi:
Shutterstock © Këshilli i Evropës.

@ Këshilli i Evropës, qershor 2021. Të gjitha të
drejtat e rezervuara. I licëncuar në Bashkimin
European sipas kushteve të miratuara.

Manuali është hartuar në kuadër të Projektit të
përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit
të Evropës “Parandalimi dhe Luftimi i trafikimit
të qenieve njerëzore në Maqedoninë e Veriut”
në bashkëpunim me Prof. Dr. Verica Stamenkova
Trajkova (Maqedonia e Veriut) dhe Marija Ang-
jellković (Serbi) në bashkëpunim me Byronë për
Zhvillimin e Arsimit.

Kontribut ndaj publikimit nga ana e Nën-grupit
për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të
qenieve njerëzore: Svetlana Cvetkovska dhe
Byroja për Zhvillimin e Arsimit: Julia Gligorova
Trajanoska, Mr. Zhaneta Çonteva dhe Danica
Talimxhioska.

Përmbajtja

1. Trafikimi i qenieve njerëzore	7
Çka nënkupton trafikimi i qenieve njerëzore?	7
Faktorët e trafikimit të qenieve njerëzore.....	8
2. Trafikimi i fëmijëve.....	11
Llojet e trafikimit të fëmijëve.....	13
3. Indikatorët e zbulimit dhe identifikimit preliminar të fëmijëve viktima potenciale të trafikimit të qenieve njerëzore	17
4. Roli i shkollës në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të fëmijëve.....	23
PARANDALIMI	24
INTERVENIMI.....	26
5. Roli i mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionistë në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të fëmijëve.....	29
6. Procedurat e denoncimit të rastit kur shfaqet dyshimi se ekziston viktimë potenciale e trafikimit të fëmijëve	33
7. Kontaktet e mekanizmit për mbrojtjen e fëmijëve.....	35

PARATHËNIE

Ky Manual u hartua si pjesë e iniciativës për ndërgjegjësim lidhur me parandalimin dhe luftimin e trafikimit të fëmijëve në Maqedoninë e Veriut. Objektivi konsiston me ndërgjegjësimin dhe përforsimin e njohurive të mësimdhënësve dhe kuadrit tjetër arsimor në lidhje me veprën penale trafikimi i fëmijëve dhe rolin të cilin ata mund ta luajnë në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të fëmijëve.

Grupi i ekspertëve për veprim kundër trafikimit të qenieve njerëzore (GRETA), mekanizmi i monitorimit dhe zbatimit të Konventës për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, është i mendimit se identifikimi i fëmijëve viktimë ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe në parandalimin e asaj që ata përsëri të bëhen viktimë të trafikimit të fëmijëve. GRETA konfirmoi se “akoma ekzistojnë boshllëqe të mëdha gjatë identifikimit të fëmijëve viktimë të trafikimit të fëmijëve”.¹

Analiza e gjendjes sa i përket trafikimit të fëmijëve në Maqedoninë e Veriut vë në dukje se numri i fëmijëve viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore, në krahasim me të rriturit, shënon rritje. Në vitin 2019 në Maqedoninë e Veriut, sipas institucioneve përkatëse dhe organizatave qytetare, nga 124 presona të identifikuar si viktimë potenciale të trafikimit të qenieve njerëzore, 85 ishin fëmijë. Nga identifikimi formal i gjashtë viktimave, katër ishin fëmijë. Në vitin 2020, shtatë viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore formalisht u identifikuan, prej të cilëve gjashtë ishin fëmijë. Megjithatë, vëllimi i mirëfilltë i problemit me sa duket është shumë më i madh nga ajo që prezantohet në të dhënat statistikore zyrtare.

Problemi i trafikimit të qenieve njerëzore rregullohet me standardet ekzistuese ndërkombëtare të inkuorporuara në Protokollin e Palermos dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (CETS nr. 197), të cilët janë sanksionuar në legjislacionin nacional të Maqedonisë së Veriut.

Sipas Kodit Penal të Maqedonisë së Veriut trafikimi i qenieve njerëzore është veprë penale e specifikuar në nenin 418-a. Me këtë nen ndalohet trafikimi i qenieve njerëzore dhe përcakton dënim me burgim prej më së paku katër vjet për kryerësin/autorin e veprës. Vepra penale trafikimi i fëmijëve është përcaktuar në nenin 418-g, ku është specifikuar dënimi prej më së paku tetë vjet burgim.

Për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore në Maqedoninë e Veriut, Komisioni Nacional, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, hartoi Strategji Nacionale dhe

¹ GREATA (2018), „Trafikimi i fëmijëve, kapitulli tematik i Raportit të 6-të për aktivitetet e GRETA”, f. 22-23 i aksesshëm në [GRETA Trafficking in children Thematic Chapter](#), i aksesuar më datë 14 prill 2021

Plan Veprim për luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe migracionit ilegal për periudhën kohore të viteve 2021-2025. Plani i Veprimit parashikon programe për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e trafikimit të fëmijëve. Programet e këtilla janë përfshirë edhe në aktivitetet e Nëngrupit për luftë kundër trafikimit të fëmijëve, i cili i monitoron nevojat specifike të fëmijëve viktime, duke i mbrojtur interesat dhe të drejtat e tyre.

Byrja për Zhvillimin e Arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, hartoi Udhëzim për procedurën e denoncimit dhe mbrojtjes së nxënësit viktimë sa i përket cilës do qoftë forme të dhunës, abuzimit ose shpërfilljes (<https://mon.gov.mk/content/?id=3288>). Udhëzimi e parashikon vendosjen e programeve për parandalimin e trafikimit të fëmijëve. Në mënyrë që t'u dilet në ndihmë shkollave gjatë zbatimit të programeve të këtilla, nevojitet të trajnohen mësimdhënësit dhe kadri tjetër profesionist në procesin arsimor lidhur me zbatimin e planeve të veprimit për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e trafikimit të fëmijëve. Manuali u hartua me synimin e rritjes së njohurive të mësimdhënësve lidhur me trafikimin e fëmijëve. Ai i përmban indikatorët e identifikimit të fëmijëve si viktime potenciale të trafikimit të qenieve njerëzore si dhe informacionet të cilat konsistojnë me referimin e viktimave potenciale të trafikimit të fëmijëve në institucionin përkatës.

Institucionet arsimore synojnë të sigurojnë kushte për zhvillimin e sigurt të fëmijëve si dhe t'i mbrojnë nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe shpërfilljes. Forma më serioze e dhunës dhe krimit që i godet fëmijët është trafikimi me fëmijë. Që të parandalohet ky trafikim, shkollat duhet të planifikojnë dhe realizojnë aktivitete përkatëse, përfshirë këtu edhe monitorimin dhe identifikimin në kohë të duhur të indikatorëve të rrezikut që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore tek nxënësit; sigurimin e mbështetjes së fëmijës pas kthimit në shkollë; zbatimin e programeve për risocializim dhe ri-integrim; bashkëpunimin me autoritetet dhe institucionet përgjegjëse për identifikimin dhe mbështetjen e fëmijëve viktime të trafikimit të qenieve njerëzore.

Programet e këtilla të parandalimit implementohen nëpër shkolla edhe atë në tre nivele: parandalimi primar, sekondar dhe terciar.

Në mënyrë që të zgjidhet problemi kompleks i trafikimit të fëmijëve duhet të aplikohet qasja multidisiplinare. Parandalimi dhe mbrojtja që i ndërmarrin shkollat, siç është përcaktuar në këtë Manual, janë vetëm njëri nga komponentët e veprimit të përgjithshëm kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Maqedoninë e Veriut, që është përshtatur në mënyrë integrale në Strategjinë Nacionale dhe Planin e Veprimit.

Për më tepër, gjatë zbatimit të aktiviteteve parandaluese të çdo niveli, shkollat bashkëpunojnë me një sërë të palëve të interesuara, duke e përfshirë: Byronë për Zhvillimin e Arsimit, qendrat për punë sociale, policinë, vetëqeverisjen lokale, organizatat qytetare, prindërit, ekspertët dhe organizatat ndërkombëtare.

Manuali përbëhet nga disa pjesë të ndërlidhura midis tyre të cilat i pasqyrojnë njohuritë dhe aftësitë e mësimdhënësve dhe kadrit profesionist të cilat u nevojiten për identifikimin e fëmijëve viktime potenciale të trafikimit të fëmijëve.

Profesor Dr. Verica Trajkova dhe Marija Angjellkoviq

Prill 2021, Shkup

Kreu 1

Trafikimi i qenieve njerëzore

Trafikimi i qenieve njerëzore është problem global përkatësisht ndërkombëtar i cili i rrezikon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Bëhet fjalë për kriminalitet të organizuar me përfitime të larta dhe me pasoja shumë të rënda ndaj viktimeve. Me miliona fëmijë, gra, të rinj, përfshirë këtu edhe burra (edhe pse në vëllim më të vogël) për çdo ditë detyrohen në prostitucion, lypje, skllavëri shtëpiake, punë në plantacione dhe në forma të tjera të eksploatimit.

Çka nënkupton trafikimi i qenieve njerëzore?

Në përputhje me nenin 4 të Konventës së Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore:

“Trafikimi i qenieve njerëzore nënkupton rekrutim, transportim, transferim ose marrje të personave, përmes kërcënimit ose përdorimit të forcës ose përmes formave të tjera të detyrimit, rrëmbimit, mashtrimit, gënjimit, abuzimit të kompetencave ose të një pozicioni vulnerabiliteti, dhënie ose marrje të pagesave ose të përfitimeve për të marr pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, me qëllim të eksploatimit të të njëjtit”.

Eksploatimi minimalisht nënkupton shfrytëzim të prostituimit të të tjerëve, ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë ose shërbime të detyruara, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, ose heqjen e organeve”.

Viktimitë e trafikimit me qenie njerëzore (TQNj) mund të jetë çdo fëmijë, grua, burrë, përkatësisht çdo person i cili ka pësuar dhimbje fizike, psikologjike ose emocionale dhe i cili ka përjetuar çfarëdo lloji të dhunës, përfshirë këtu edhe dhunën seksuale, mund të jetë viktimitë e TQNj.

E përbashkëta për të gjitha viktimat: janë mashtruar, janë vënë në lajthitje, janë shitur, janë ekspozuar në dhunë të përditshme mizore, fizike dhe psikologjike, janë trajtuar si robër si burim për përfitime, u janë shkelur të drejtat, ndërsa jetën e kanë pasur në rrezik.

Ekzistojnë mënyra të ndryshme përmes të cilave viktimat potenciale rekrutohen, përkatësisht joshen dhe mashtrohen në mesin e të cilave:

- Rekrutimi, nga ana e individëve - rekrutues, të cilët veprojnë në fqinjësi ose jashtë vendit dhe ofrojnë punë sezonale.
- Përmes rrjeteve joformale, ku bëjnë pjesë të njohur, miq, ndërsa ndonjëherë, për fat të keq, madje edhe anëtarë të familjes.
- Përmes reklamimit në mediat në shpallje tërheqëse ose vende pune ligjore/gjysmë ligjore (të dyshimta) brenda dhe jashtë vendit, si për shembull: model në agjencinë e modës, gara bukurie, bejbi-siterë/e, kamarrierë dhe këngëtarë, punë në kroçere, ndërmjetësimi në lidhjen e martesës me të huaj.
- Viteve të fundit, gjithnjë e më shumë viktimat potenciale rekrutohen edhe përmes internetit. Në fillim, kontakti ka të bëjë me një ftesë naive dhe miqësore për shoqërinë, për takim dashurie, dhe pastaj pason deklarimi i dashurisë, oferta për martesë, dhe pastaj përfundon me shantazh, me publikim të fotografive provokative dhe me turpërim.
- Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore shpeshherë rrëmbehen brutalisht.

Njerëzit mund të trafikohen në kufijtë e vendit të tyre (trafikim i brendshëm i qenieve njerëzore), jashtë vendit, madje edhe në kontinente të tjerë (trafikim transnacional të qenieve njerëzore).

Vendi mund të jetë vendi i origjinës, ku viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore rekrutohen; vendi i transitit, përmes të cilit viktimat transportohen në një vend tjetër për shkak të eksploatimit të tyre; dhe vendi i destinimit, ku palët dhe viktimat vendase të trafikimit të qenieve njerëzore eksploatohen. Maqedonia e Veriut bën pjesë në të tria kategoritë.

Faktorët e trafikimit të qenieve njerëzore

Në Maqedoninë e Veriut, trafikimi i qenieve njerëzore është vepër penale, e parashikuar në nenin 418-a (trafikimi i qenieve njerëzore) dhe në nenin 418-g (trafikimi i fëmijëve) të Kodit Penal. Më shumë faktorë shpijnë drejt trafikimit të fëmijëve, të cilët mund t'i klasifikojmë në dy grupe:

- *Faktorë që bëjnë shtytje, ku bëjnë pjesë: varfëria në vendin/rajonin e origjinës, tranzicioni ekonomik, mos arsimimi, mos informimi për trafikimin e qenieve njerëzore, mundësitë e pamjaftueshme për punësim në vendin e origjinës, familjet disfunktionale, diskriminimi gjinor në tregun e punës, të gjitha format e dhunës-dhuna në familje, mospasja e mundësive për migrim të ligjshëm.*
- *Faktorë joshës: dëshira për punësim dhe për "pagë të mirë dhe profit të mirë", sigurimi i mbështetjes financiare nga familja, qasje në përfitime të caktuara, kërkimi për arsim më cilësor, dëshira për aventurë dhe jetë zbavitëse, oferta "joshëse" për martesë, njoftimi i vendeve dhe kulturave të reja, dëshira për një status më të mirë social etj.*




Foto 1: Faktorët e TQNj që bëjnë shtytje dhe joshin

Sipas të dhënave të Raportit të GRETA² në lidhje me TQNj në 47 vende të Këshillit të Evropës, numri i viktimave të TQNj ka shënuar rritje prej 44 % nga viti 2015 deri në vitin, përkatësisht 10.598 viktima janë identifikuar në vitin 2015, ndërsa 15.310 janë identifikuar në vitin 2018.




Foto 2: Numri i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në Maqedoninë e Veriut, 2015-2020

Në Maqedoninë e Veriut ndërmjet viteve 2015 dhe 2020 janë identifikuar 34 viktima të trafikimit të qenieve njerëzore, prej të cilave 24 ishin fëmijë. Në vitin 2019 nga gjithsej 124 viktima potenciale të identifikuar nga institucionet dhe organizatat qytetare, 85 ishin fëmijë.

² GRETA (2019), Raporti i 9-të i përgjithshëm për aktivitetet e GRETA, i aksesshëm në <https://rm.coe.int/9th-general-report-on-the-activities-of-greta-covering-the-period-from/16809e169e>, i aksesuar më datë 8 prill 2021.

Numri i viktimave të identifikuara sipas viteve




Foto 3: Numri i të rriturve dhe fëmijëve viktima të trafikimit të qenieve njerëzore në Maqedoninë e Veriut, 2019-2020

Fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore në Maqedoninë e Veriut me sa duket është më i lartë se numrat zyrtar, duke i pasur parasysh numrat e viktimave potencialisht të identifikuara të trafikimit të fëmijëve.³

³ Shih raportet vjetore të Komisionit Nacional për Luftë Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migracionit Jolegal të aksesshëm në [Годишни извештаи на Националната Комисија - Национална Комисија \(nacionalnakomisija.gov.mk\)](http://godishniizvezhtai.nacionalnakomisija.mk) i aksesuar më datë 16 prill 2021.



Kreu 2

Trafikimi i fëmijëve

Sipas përkufizimit fëmijët janë vulnerabil. Ata janë në zhvillim, sa u përket mundësive të tyre psikofizike dhe fizike. Fëmijët kanë kapacitete të kufizuara për identifikimin e situatave dhe aktiviteteve të rrezikshme, si dhe për mbrojtjen nga rreziqet. Për shkak të kësaj, ata janë të ekspozueshëm ndaj llojeve të ndryshme të abuzimeve, me lehtësi mashtrohen dhe bëhen viktima të trafikimit të fëmijëve. Në mënyrë që të parandalohet fëmijët të bëhen viktima të TQNj, është më se e nevojshme viktimat potenciale të TQNj në mesin e nxënësve të zbulohen dhe identifikohen në fazën e hershme.

Trafikimi i fëmijëve, si dhe të gjitha llojet e tjera të abuzimit të fëmijëve, janë problem serioz. Nga njëra anë rrezikohet shëndeti i fëmijës, ndërsa nga ana tjetër edhe zhvillimi i tij fizik dhe psikofizik si dhe arsimimi i tij. Trafikimi i fëmijëve organizohet në mbikëqyrje apo kontroll të personave të cilët kanë dobi materiale ose ndonjë dobi tjetër. Ashtu si edhe trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i fëmijëve paraqet veprë penale, dhe mund të ketë karakteristika të veprës së organizuar dhe transnacionale. Karakteristikat specifike të trafikimit të fëmijëve e imponojnë edukimin dhe trajnimin e mësimdhënësve dhe të kuadrove tjera relevante arsimore lidhur me procedurat e veçanta për mbrojtjen e fëmijës dhe referimin e tij deri te ndihma adekuate.

Trafikimi i fëmijëve, sipas nenit 418-g të Kodit Penal, nënkupton: rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim të fëmijës me qëllim të eksploatimit të tij, ndërkaq do të konsiderohet si "trafikim të qenieve njerëzore" madje edhe nëse nuk është aplikuar asnjëra nga masat. Pëlqimi i fëmijës viktimë nuk është i rëndësishëm.

Karakteristikat tipike të fëmijëve në rrezik të veçantë nga trafikimi i fëmijëve janë:

- vijnë nga familje të varfra, disfunktionale,
- pa prindër ose pa kujdes prindëror,
- nga familje në të cilat është i pranishëm ndonjë ves (alkoolizëm, varësia nga substancat narkotike etj.),
- arsim ose edukim problematik,
- në rrugë,
- të paregjistruar, përkatësisht nuk janë të regjistruar në librat e amzës,
- nga mjediset rurale,
- të vendosur në institucione ose në banesa të vogla grupore,
- të përjashtuar nga arsimi,
- me nivel të ulët të vetë respektimit dhe rezistencës,
- të painformuar lidhur me çështjet e trafikimit të fëmijëve,
- me dëshirë të adoleshentit për jetë më të mirë, dhe
- me aftësi të kufizuara.

Varfëria, historiku i dhunës seksuale dhe fizike bëjnë pjesë në faktorët të cilët fëmijën e bëjnë vulnerabil ndaj trafikimit të fëmijëve. Disa fëmijë i rrëmbejnë dhe i shesin, të tjerët i mashtrojnë me premtime për një jetë më të mirë dhe punë më të mirë, ndërsa disa fëmijë mendojnë se opsioni i vetëm i realizueshëm është t'i besojnë trafikantit me qenie njerëzore. Sapo të futen në kurthin e trafikantit me qenie njerëzore, fëmijët mbahen dhe eksploatohen në kushte të ngjashme si ato të robërisë.

Varësisht nga gjinia dhe moshja e fëmijëve, mund të jenë fragjil ndaj formave të ndryshme të trafikimit të fëmijëve: vajzat më së shpeshti shfrytëzohen për prostitucion, pornografi dhe aktivitete të tjera seksuale; djemtë shfrytëzohen për aktivitete shërbyese ose zeytare, ose për aktivitete të ngjashme, si edhe në bujqësi; adoleshentët shfrytëzohen për kryerjen e veprave penale; fëmijët më të vegjël shfrytëzohen për punë shtëpie, lypje dhe për kryerjen e veprave penale; bebet dhe foshnjat, pavarësisht gjinisë, janë të përshtatshme për trafikimin e qenieve njerëzore me qëllim të birësimit; dhe të gjithë këto, pavarësisht gjinisë dhe moshës, mund të shfrytëzohen për heqjen e paligjshme të organeve.



Llojet e trafikimit të fëmijëve

Fëmijët trafikohen për shkak të:

- eksploatimit seksual, punës ose shërbimit me detyrim, robërisë apo praktikave të ngjashme me robërinë,
- skllavërisë,
- martesës së detyrueshme,
- lypjes,
- birësimit të kundërligjshëm,
- detyrimit për kryerjen e veprave penale,
- heqjes së kundërligjshme të organeve.

Eksploatimi seksual, puna me detyrim, robëria

“Abuzimi seksual i fëmijës” është një nocion i përgjithshëm i cili përfshin disa forma të eksploatimit seksual dhe mënyra të abuzimit: shqetësimi seksual i fëmijës me qëllim të eksploatimit seksual, prostitucionit, incestit, dhunimit, pornografisë së fëmijëve, e që e nënkupton shfaqjen e fëmijëve të përfshirë në aktivitete reale ose të simuluar eksplicite seksuale, ose shfaqjen e gjenitaleve të fëmijëve.

Trafikimi i fëmijëve me qëllim të eksploatimit të punës nënkupton: abuzim të punës së fëmijës, e cila zbatohet në mënyra, në kohë dhe në kushte pune që nuk korrespondojnë me moshën dhe interesat e fëmijës, kështu që e rrezikon shëndetin e tyre fizik dhe mendor, zhvillimin e tyre emocional, moral dhe social, dhe ia pamundëson fëmijës rregullisht ta përcjellin procesin mësimor në shkollë, ose e detyron ta braktis shkollën, ndërsa organizohet, nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e personave të cilët kanë përfitime materiale dhe përfitime të tjera nga e njëjta. Ekzistojnë disa lloje të trafikimit të fëmijëve me qëllim të eksploatimit të punës, në mesin e të cilave:

- punë në rrugë (larja e xhamave të automjeteve, shitja e gjësendeve të vogla),
- punë në bujqësi (punë sezonale, vjelja e pemëve dhe perimeve),
- veprimtari shërbyese në objekte hotelerie (kameriere, shoqëruese në tavolina me mysafirë, kërcimtare),
- punë në ferma (rritja dhe mbarështimi i kafshëve shtëpiake),
- në ndërtimtari, në sektorin minerar, në fabrika.

Punë në amvisëri - skllavëri

Fëmijët e të dyja gjinive, ndonjëherë edhe më të rinj se moshja 10 vjeçare, angazhohen brenda ditës nëpër amvisëri dhe kthehen natën vonë në shtëpinë e tyre. Fëmijët më të rritur, veçanërisht vajzat, më së shpeshti punësohen dhe jetojnë në shtëpinë e punëdhënësit. Ato më së shpeshti janë nën kontrollin e plotë të punëdhënësit dhe të antarëve të familjes së tij, pa mundësi arsimimi.

Martesa e detyrueshme

Martesa e detyrueshme, martesat e fëmijëve, nuse me porosi zakonisht iu ndodhin vajzave të moshës nga 14 deri 16 vjeçare me persona nga ndonjë rajon tjetër, ose më së shpeshti me persona jashtë vendit. Bëhet fjalë për një paravan pas të cilit fshihen organizatat kriminale të trafikimit të qenieve njerëzore, me ç'rast vajzat dhe gratë e moshës madhore ofrohen si nuse, por privatisht shiten për prostitucion, detyrohen të lidhin martesë ose mbahen në skllavëri shtëpiake. Ky lloj i trafikimit të fëmijëve, për fat të keq, ndonjëherë zhvillohet me pëlqimin e prindërve (pavarësisht si është marr). Zakonisht procesi fillon përmes agjencive për ndërmjetësim, përmes ndërmjetësuesit (ndonjë i njohur familjar), i cili jeton jashtë vendit dhe u premtun prindërve një jetë më të mirë për fëmijën e tyre, ose ju ofron kompensim monetar. Fëmijët në mënyrë të (kundër) ligjshme transportohen në vendin e destinacionit tek “porositësit” dhe përfundojnë si viktime të trafikimit të fëmijëve me qëllim të skllavërisë, lypjes, kryerjes së aktiviteteve kriminale dhe ngjashëm.

Lypja

Lypja është një aktivitet i cili realizohet në rrugë me komunikacion të dendur, në semaforë, para qendrave të mëdha ose marketeve. Më së shpeshti realizohet nga një grup i fëmijëve, ose nga fëmija/fëmijët në shoqërim të personave të rritur.

Në grupet e rrezikshme bëjnë pjesë fëmijët e të dyja gjinive, nga bebe deri te adoleshent, më së shpeshti në moshë prej 8 deri 14 vjet, fëmijë të cilët e kanë ndërprerë shkollimin, fëmijë nga familje me marrëdhënie të çrregulluara familjare, fëmijë të shpërfillur, të braktisur, fëmijë nga grupet e marginalizuara.

Lypja e detyrueshme e nënkupton detyrimin e fëmijëve që në mënyra të ndryshme të lypin para nga njerëzit në rrugë. Për këtë aktivitet shfrytëzohen fëmijët meqë ata më së lehti nxisin bashkëndjenjë tek qytetarët e rastit dhe me të njëjtit trafikanti me qenie njerëzore manipulon lehtësisht. Ato i mbikëqyr një person i rritur i cili ua mbledh paratë. Fëmijët janë të detyruar të lypin, në të kundërtën ndëshkohen fizikisht ose i lejnë të uritur. Për lypjen me detyrim shfrytëzohen edhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

Birësimi i kundërligjshëm

Birësimi i kundërligjshëm ose shtrëngimi për dhënien e pëlqimit për “dhënien e fëmijës për birësim”, për shkak të kërkesës së madhe është edhe një formë e trafikimit të fëmijëve. “Bebi mafia” më së shpeshti i keqpërdor fëmijët e nacionalitetit romë. Kërkesa e madhe për birësim nuk mund të kënaqet në të gjitha rastet, dhe kjo krijon kërkesë për birësimin e paligjshëm, e që shpeshherë kënaqet përmes trafikimit të fëmijëve për këtë qëllim. Kjo në mënyrë të veçantë ka të bëjë me vendet në zhvillim, ku kombinimi i varfërisë ekstreme, legjislacioni joefikas dhe burokracia e mundësojnë ofertën e fëmijëve, ndërsa nevoja për fëmijë dhe fuqia financiare në vendet në të cilat përfundojnë fëmijët, e përbëjnë palën e kërkesës.

Detyrimi për kryerjen e veprave penale

Ky lloj i trafikimit të fëmijëve kryesisht ndodh në qytetet e mëdha, ku fëmijët e vegjël të të dyja gjinive trajnohen të bëjnë kriminalitet të imët, siç është: hajdut xhепash dhe vjedhje të imta (grabitja e strajcave, vjedhja e bankomatëve), por edhe vepra të

rënda penale kundër pronës, madje edhe shitja e substancave narkotike. Për shkak të faktit që shumica e sistemeve juridike parashikojnë dënime më të ulëta të miturit (apo kurrfarë dënimesh kur kryerësi është nën moshën e caktuar) kriminelët të cilët i keqpërdorin fëmijët në këtë mënyrë, fëmijët i perceptojnë si mbrojtja e tyre nga përgjegjësia penale. Fëmijët – viktimat shpeshherë njëkohësisht u nënshtrohen disa llojeve të eksploatimit kriminal.



Kreu 3

Indikatorët e zbulimit dhe identifikimit preliminar të fëmijëve viktimë potenciale të trafikimit të qenieve njerëzore

Zbulimi i hershëm i viktimave potenciale ose të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore është baza për reduktimin e vulnerabilitetit dhe sigurimit të ndihmës dhe mbrojtjes për viktimat. Për këtë qëllim përdoren shumë indikatorë të cilët shpijnë në supozimin se një person është viktimë potenciale e trafikimit të qenieve njerëzore. Indikatorët janë një “mekanizëm” i mirë i cili u ndihmon të punësuarve në sistemin edukativo arsimor në mënyrë strukturore dhe funksionale, në mënyrë sistematike ta kontrollojnë atë që e kanë vërejtur tek ndonjë nxënës/nxënese, që mund të ndërlihdet me trafikimin e fëmijëve dhe që e lehtëson veprimin e mëtutjeshëm për referimin dhe mbrojtjen e viktimave. Njohja e tyre ia mundëson mësimdhënësit/bashkëpunëtorit profesionist të dyshoj, por edhe ta konfirmoj dyshimin, nxënësi/nxënësja, tek e cila janë vërejtur disa nga këto shenja/indikatorë a është viktimë potenciale e TQNj.

Identifikimi preliminar i viktimave potenciale të trafikimit të fëmijëve

Identifikimi preliminar ka të bëjë me kontaktin e parë me viktimën e mundshme gjatë së cilit vërehet se a ekziston prezenca e indikatorëve të trafikimit të fëmijëve. Vlerësohet se a ekziston rrezik që fëmija të jetë viktimë potenciale e trafikimit të fëmijëve. Ky lloj i identifikimit ka të bëjë me **përcaktimin e rrezikut**, por jo edhe verifikimin se personi është viktimë e trafikimit të fëmijëve.

Në mënyrë që fëmija të identifikohet si viktimë e trafikimit të fëmijëve, nevojitet të ekzistoj dashja për eksploatimin e tyre ose së paku të jetë bërë rekrutimi për eksploatimin e tyre me qëllim të përfitimit të dobisë së kundërligjshme pronësore. Identifikimin që konsiston me atë se fëmija a është viktimë e trafikimit të fëmijëve e kryen punëtori social dhe/ose polici.

Ekzistojnë grupe të ndryshme të indikatorëve të hartuara nga organizatat ndërkom-bëtare dhe organizatat qytetare të cilat synojnë ta fuqizojnë rolin sa i përket procesit të identifikimit të viktimave (policë, inspektor të punës, punonjës social, mësimdhënësit). Për më shumë informacione shih aneksin/shtojcën.

Ndarja e indikatorëve të fëmijëve viktima potenciale ose viktima të TQNj

Siç theksuam, ekzistojnë ndarje dhe grupime të ndryshme të indikatorëve të trafikimit të qenieve njerëzore/fëmijëve, por në të gjitha këto nuk ka indikatorë krejtësisht tipik për ndonjë lloj të ndryshëm të trafikimit të fëmijëve. Për nevojat e këtij Manuali u bë ndarja e indikatorëve të trafikimit të fëmijëve në grupet si vijon:

A. Indikatorë të veçantë për identifikimin e fëmijëve të cilët janë viktima potenciale të TQNj dhe

B. Indikatorë specifik për identifikimin e fëmijëve të cilët janë viktima të një lloji të caktuar të trafikimit të fëmijëve

A. Indikatorë të veçantë për identifikimin e fëmijëve të cilët janë viktima potenciale të TQNj

1. Shenjat e abuzimit fizik

Fëmijët kanë:

- shenja të punës së rëndë fizike, (duar të ashpra, fluska),
- lëndime të cilat nuk korrespondojnë me sqarimet e shkaqeve,
- shpjegime alogjike si janë shkaktuar lëndimet,
- ndryshime të shpeshta të shëndetit fizik,
- dhimbje të shpeshta të kokës, dhimbje të shpeshta të stomakut,
- pamje e lënë pas dore, e uritur, e çrregullt,
- shenja të lodhjes së vazhdueshme (fizike),
- lëndime simetrike (lëndime të cilat janë të njëjta në të dy krahët ose në pjesë të kundërta të trupit),
- lëndime të shumëfishta, në faza të ndryshme të shërimit, dhe
- lëndime të kamufluara me rroba.

2. Shenjat e abuzimit psikologjik

Fëmijët:

- duken të stepur, pasiv, të pasigurt dhe të pashpresë,
- fëmijët i shmangen kontaktit “sy më sy”,
- manifestojnë agresivitet
- tërhiqen dhe izoloohen,
- manifestojnë depresion, frikë, anksozitet,
- manifestojnë përgjumje, ndodh që të flenë në orën e mësimt,
- manifestojnë lodhje psikologjike,

- duken të lodhur, të hutuar,
- duken të turpshëm,
- vështirë i kontrollojnë emocionet – hidhërimin, zemërimin, mllëfin dhe përgjërimin,
- manifestojnë frikë ose shqetësim,
- kanë shenja të dezorientimit, konfuzionit, fobive ose sulmeve të panikut,
- janë të dezorientuar në kohë dhe hapësirë.

3. Shenja biheviorale – sjellja e fëmijës si indikator

Fëmijët:

- manifestojnë oscilime të dukshme në sjelljen e tyre (nga qetësia e pa pritshme deri në anksozitetin e shprehur),
- manifestojnë ndjenjë faji për situatën e tyre,
- manifestojnë sjellje delikvente,
- manifestojnë shenja abuzimi të mjeteve qetësuese ose mjeteve të cilat krijojnë varësi,
- manifestojnë sjellje paranoike ose nënshtruese,
- i shmangen bisedës së drejtpërdrejt,
- kur flasin japin deklarime kontradiktore, të pa kompletuara ose të pavërteta,
- janë pasiv ose hiperaktiv,
- nuk kanë besim te askush,
- i shmangen bisedës për situatën në të cilën gjenden,
- nuk mund të vendosin dhe të kenë marrëdhënie miqësore me moshatarët,
- nuk kanë miq të moshës së tyre,
- nuk janë të interesuar për mësim,
- e shkelin ligjin (konflikt me policinë),
- manifestojnë oscilime sa i përket përqendrimit – defokusim,
- nuk mund të përqendrohen në procesin mësimor,
- shpeshherë vonohen në shkollë dhe mungojnë nga shkolla (veçanërisht në periudhën e punëve sezonale),
- nuk japin sqarime pse vonohen, refuzojnë të përgjigjen ose të japin përgjigje të cilat dukshëm janë të pasakta,
- kanë vështirësi gjatë nxënies dhe e ulin suksesin,
- nuk i bëjnë detyrat e shtëpisë,
- manifestojnë prirje për një sjellje të rrezikshme, riskante dhe të kundërligjshme,
- nuk marrin pjesë në aktivitetet jashtëmësimore,
- në mbledhjet prindërore nuk merr pjesë prindi/kujdestari.

Zakonisht, këto ndryshime të sjelljes, nuk do të shfaqin dyshime se ndoshta nxënësi është viktimë potenciale e trafikimit të qenieve njerëzore, por mund ta vë në dukje ndonjë problem të nxënësit, për shembull, dhuna në familje ose eksploatimi i llojit të ndryshëm.

Megjithatë, ekzistimi i ndonjërit prej këtyre indikatorëve kërkon kujdes më të madh nga ana e mësimitdhënësve për shkak të mundësisë së trafikimit të fëmijëve.

Nevojitet të detektohen minimum 3 indikatorë që të nxitet dyshimi për mundësinë që nxënësi është viktimë potenciale e trafikimit të fëmijëve.

Për më tepër, është jashtëzakonisht e rëndësishme që mësimitdhënësit në shkollë të kenë informacione, por edhe të jenë të vetëdijshëm, se shkak i mundshëm për ndryshimin e sjelljes së nxënësit mund të jetë edhe trafikimi i fëmijëve, që të mundet në kohë të duhur të konsultohen me bashkëpunëtorët profesional si dhe të ndërmerren masa përkatëse për mbrojtje nga situatat e dëmshme. Gjithsesi, se një gjë e këtillë nuk e nënkupton se automatikisht duhet të përcaktohen ndryshimet në sjelljen e fëmijës si rezultat i trafikimit të fëmijëve, me ç'rast mund të neglizhohen shkaqe tjera të mundshme, siç është dhuna në familje etj. përkundrazi, mësimitdhënësi duhet vetëm ta rris kujdesin e tij për ekzistimin e mundësisë së trafikimit të fëmijëve. Në rast se nuk bëhet fjalë për trafikimin e fëmijëve, atëherë prezenca e këtyre indikatorëve mund ta vë në dukje se nxënësi ballafaqohet me probleme të tjera, dhe se ka nevojë për ndihmë dhe mbështetje profesionale.

B. Indikatorë specifik për identifikimin e fëmijëve të cilët janë viktimë të ndonjë lloji të caktuar të trafikimit të fëmijëve

1. Indikatorët e eksploatimit të punës së fëmijëve

Karakteristikat tipike të rrethanave të punës ku fëmijët viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore për qëllimet e eksploatimit të punës:

- punojnë në ferma/stane blegtorale, në ekonomitë bujqësore, sallone për masazh, objekte hotelerie, klube të natës, fabrika, uzina, miniera, plantazhe,
- kryejnë shërbime nën kërcënim dhe pa pëlqim,
- shfrytëzojnë pajisje dhe vegla të cilat nuk janë të përshtatura që fëmijët të punojnë me të njëjtat,
- lëvizja e tyre kontrollon nga persona të tjerë,
- punojnë punë jopërkatëse për moshën e tyre, në kushte jopërkatëse me shumë orë pune, pa pauza dhe pa kohë të lirë, pa respektimin e dispozitave ligjore,
- disiplinohen përmes dhunës fizike, dënimeve monetare, kanë shujta dhe lëvizje të kufizuara,
- nuk guxojnë të largohen nga puna, përkatësisht nga "pronari".

2. Indikatorët e fëmijëve viktimë të lypjes

Ato janë:

- fëmijë në moshë të ndryshme (në moshë parashkollore, shkollë dhe adoleshente),
- fëmijë me aftësi të kufizuara (më së shpeshti me pengesa fizike),
- kanë lëndime fizike të cilat duket se janë bërë me dashje,
- këmbëngulës gjatë lypjes, pa dallim të kushteve klimatike,
- vazhdimisht të mbikëqyrur/kontrolluar në një distancë të caktuar nga ana e personave të tjerë.

3. Indikatorët e trafikimit të fëmijëve për shkak të kryerjes së veprave penale

Fëmijët:

- detyrohen të bëjnë vjedhje,
- ndëshkohen nëse nuk "mbledhin" ose vjedhin mjaftueshëm para,
- merren me distribuimin dhe shitjen mjeteve të palejueshme, substanca narkotike, armë, sende të vjedhura,
- për të cilët ka informacione për përfshirjen e tyre paraprake në ndonjë krim të ngjashëm në një shtet/vend tjetër,
- për cilat moshë të përkatësisë së njëjtë etnike pohojnë se fëmija rastësisht është "gjetur" dhe jo se është shoqëruar nga ato, kur janë kapur gjatë kryerjes së veprës penale.

4. Indikatorët të cilët e vënë në dukje ekzistimin e eksploatimit seksual të fëmijës

Fëmijë viktimë të eksploatimit seksual:

- më së shpeshti janë vajza në moshë prej 12 deri 18 vjet,
- punojnë në kafene, hotele, motele, sallone për masazh,
- nuk guxojnë ta refuzojnë urdhrin për ta shërbyer klientin,
- nuk guxojnë të largohen nga "puna" përkatësisht nga "pronari",
- shoqërohen nga persona të cilët i kontrollojnë,
- ndonjëherë i nënshtrohen seksit të dhunshëm,
- për të cilët ekzistojnë indicie se janë viktimë të incestit,
- refuzojnë të flasin për abuzimin seksual.

5. Indikatorët e trafikimit të fëmijëve për skllavëri në shtëpi

Fëmijët:

- jetojnë në familje ku edhe eksploatohen,
- angazhohen të punojnë punë jopërkatese,

- ushqehen ndaras nga anëtarët e familjes,
- ushqehen me mbetjet e ushqimit,
- nuk kanë hapësirë private dhe flenë në hapësira jopërkatese,
- asnjëherë nuk dalin vet dhe nuk komunikojnë me persona të tjerë nga fqinjësia,
- u nënshtrohen ofendimeve, keqtrajttimeve, kërcënimeve dhe dhunës,
- disiplinohen përmes dënimeve fizike,
- nuk kanë liri ta braktisin familjen.

6. Indikatorët e fëmijëve të cilët janë viktimë të martesës së detyrueshme “nuse me porosi”

Martesat e detyrueshme të fëmijëve karakterizohen me:

- regrutimin e fëmijëve përmes prindërve, familjarëve dhe personave të tjerë për “lidhje të martesës” jashtë vendit,
- premtime të rrejshme dhe mashtrime për një jetë më të mirë dhe komoditet,
- organizimin e “dasmës” pa prezencën e dhëndrit,
- nënshtrimin e fëmijëve ndaj më shumë llojeve të eksploatimit, veçanërisht ndaj eksploatimit seksual,
- lypje, vjedhje, skllavëri,
- dhunë fizike dhe psikologjike nga ana e anëtarëve të familjes.



Kreu 4

Roli i shkollës në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të fëmijëve

Shkolla është institucioni i cili e ka për detyrë t'u sigurojë kushte për rritje dhe zhvillim të sigurt të nxënësve dhe mbrojtje nga të gjitha llojet e dhunës, abuzimit dhe shpërfilljes. Forma më e rëndë e dhunës dhe veprës penale ndaj të cilës fëmijët dhe të rinjtë mund të ekspozohen është trafikimi i qenieve njerëzore, dukuri kjo e cila për fat të keq vite me radhë është e pranishme në suaza botërore por edhe tek ne.

Në Maqedoninë e Veriut, numri më i madh i viktimave të identifikuara në krahasim me të rriturit janë fëmijët. Sipas kësaj, procesit të parandalimit dhe luftimit të trafikimit të fëmijëve duhet t'i përkushtohet vëmendje e veçantë. Së këtejmi duhet të përfshihen të gjitha palët e interesuara, në mesin e të cilave shkolla, e cila si një institucion edukativo-arsimor ka një rol të rëndësishëm në parandalimin e kësaj dukurie. Në mënyrë që shkolla me sukses të marrë pjesë në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve/nxënësve nga trafikimi i qenieve njerëzore, është më se e nevojshme mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesionistë dhe shërbimet e tjera relevante të shkollave, ta njohin problemin e trafikimit të qenieve njerëzore/fëmijëve, mënyrat e detektimit të hershëm të fëmijëve viktimë potenciale dhe referimin e tyre deri te institucioni kompetent. Njohuritë më të mira dhe trajnimi i kuadrit mësimor lidhur me trafikimin e fëmijëve në masë të konsiderueshme do të ndikojë në parandalimin dhe luftimin e tij tek fëmijët dhe më gjerë në shoqëri.

Kompleksiteti i fenomenit trafikimi i fëmijëve kërkon ndërgjegjësim të plotë, trajnim dhe fuqizim të kapaciteteve të një vargu të institucioneve prej të cilave kur bëhet fjalë për fëmijë, më e rëndësishme është shkolla.

Detyrimet e shkollës në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të fëmijëve janë si vijon:

- t'i identifikojë dhe monitorojë shenjat e para tek nxënësit të cilat e vënë në dukje trafikimin e mundshëm të qenieve njerëzore;
- t'i sigurojë mbështetje fëmijës në procesin e ri-integrimit në shkollë por edhe në mjedisin jetësor;
- të bashkëpunojë me autoritetet dhe institucionet kompetente për identifikimin dhe mbështetjen e fëmijëve viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore.

Këto detyrime shkolla i realizon përmes:

- monitorimit të vazhdueshëm të ndryshimeve tek fëmijët,
- aplikimit të indikatorëve për identifikimin preliminar të fëmijëve viktimë potenciale,
- e njofton qendrën kompetente për punë sociale, policinë dhe prindërit/kujdestarët.

Gjatë luftimit të trafikimit të fëmijëve shkolla në dispozicion ka dy mekanizma, si vijon: parandalimin dhe intervenimin,

PARANDALIMI

Parandalimi është mekanizmi më i rëndësishëm për parandalimin dhe zbulimin në kohë të duhur të aktiviteteve që kanë të bëjnë me trafikimin e mundshëm të fëmijëve, si dhe për ndërmarrjen e intervenimit me qëllim të zbutjes së pasojave tek fëmijët.

Në aktivitetet parandaluese duhet të përfshihen mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesionist, nxënësit, drejtori dhe prindërit, profesionistët nga fusha e vetëqeverisjes lokale, organizatat joqeveritare të cilat punojnë në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore.

Aktivitetet parandaluese në shkollë planifikohen në një Program të veçantë ose në kuadër të Programit vjetor për mbrojtje nga dhuna.

Krahas aktiviteteve të planifikuara në lidhje me mbrojtjen nga dhuna, shkollat, në kuadër të nevojave të tyre dhe resurseve që i kanë në dispozicion, duhet të planifikojnë dhe të realizojnë aktivitete plotësuese parandaluese në fushën e trafikimit të fëmijëve/nxënësve.

Llojet e parandalimit

Në shkollë parandalimi zbatohet në tre nivele:

- Parandalimi primar,
- Parandalimi sekondar - intervenimi,
- Parandalimi terciar - risocializimi.




Foto 4: Llojet e parandalimit

Veçanërisht i rëndësishëm është niveli i parë-parandalimi primar - i cili nënkupton aktivite për parandalimin e dukurisë së trafikimit të fëmijëve.

Niveli i dytë është parandalimi sekondar, aktivite të cilat ndërmerren pas zbulimit të shenjave/indikatorëve të parë lidhur me trafikimin e mundshëm të qenieve njerëzore.

Aktiviteti themelor në kuadër të parandalimit sekondar është intervenimi, përkatësisht ridërgimi i rastit deri te institucioni përgjegjës përkatësisht deri te Qendra për Punë Sociale ose deri te policia për identifikim (përfundimtar) - a është nxënësi i viktimit e trafikimit të qenieve njerëzore ose jo.

Niveli i tretë – parandalimi terciar “risocializimi dhe riintegrimi” përbëhet nga aktivite të cilat ndërmerren pas identifikimit të fëmijës si viktimit e trafikimit të qenieve njerëzore. Ky lloj i parandalimit në Maqedoninë e Veriut implementohet në Qendrën për Viktimat e Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

Pas largimit nga Qendra, roli i shkollës është fëmija të përfshihet në procesin arsimor, të ndihmohet t’i tejkalohet traumat, t’i përkushtohet vëmendje në mënyrë që të parandalohet që ai përsëri të bëhet viktimit e trafikimit të fëmijëve.

Roli i shkollës në parandalimin e trafikimit të fëmijëve

Hapi i parë në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve parandaluese për parandalimin e trafikimit të fëmijëve konsiston me: përgatitjen e programit për parandalimin e trafikimit të fëmijëve, ose me përfshirjen e programit për parandalimin e trafikimit të fëmijëve në programin për mbrojtje nga dhuna, shpërfillja dhe neglizhenca. Në Program specifikohen aktivitetet parandaluese dhe interventet për parandalimin e dukurisë së trafikimit të fëmijëve. Në implementimin e programit dhe aktiviteteve parandaluese për luftë kundër trafikimit të fëmijëve mund të përfshihen edhe persona të tjerë, duke i përfshirë këtu edhe përfaqësuesit e Qendrës për Punë Sociale.

Nga anëtarët për implementimin e programit për parandalimin e trafikimit të fëmijëve zgjidhet personi përgjegjës (më së miri nga bashkëpunëtorët profesionistë). Nëse ndonjë mësues ndonjë apo ndonjë i punësuar tjetër në shkollë dyshon se ndonjë nxënës është viktimit e trafikimit, atëherë rastin e denoncojnë tek personi përgjegjës.

Personi përgjegjës i paraqet raport drejtorit. Ky raport dërgohet në Qendrën për Punë Sociale për identifikimin përfundimtar.

Përbajtja e realizimit të aktiviteteve parandaluese në shkollë

Programi i aktiviteteve parandaluese përfshin:

- trajnime të mësimdhënësve për identifikimin e indikatorëve të trafikimit të fëmijëve,
- shfrytëzimin e indikatorëve për identifikimin preliminar të viktimave potenciale të trafikimit të fëmijëve,
- edukimin e nxënësve për rreziqet e trafikimit të fëmijëve dhe mënyrat e mbrojtjes, më së miri përmes mësimin ndërmjet nxënësve moshatar.
- Edukimi i prindërve për identifikimin e ndryshimeve të para sa i përket sjelljes së fëmijës së tyre dhe bashkëpunimi me shkollën me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie.

Mënyrat e realizimit të aktiviteteve parandaluese në shkollë

Ekzistojnë më shumë mënyra për realizimin e aktiviteteve parandaluese në shkollë:

- tribuna,
- diskutime,
- prezantime,
- edukim ndërmjet nxënësve moshatarë,
- punëtori,
- forum teatër,
- filma për trafikimin e fëmijëve,
- fushata në rrjetet shoqërore.

INTERVENIMI

Mekanizmi i dytë për luftimin e trafikimit të fëmijëve është intervenimi.

Kur do të shfaqet dyshimi, ose kur ekziston ndonjë informacion se fëmija është viktimë e ndonjë lloji të trafikimit të fëmijëve, detyrimi i shkollës është të intervenoj dhe të:

- bashkëpunojë me organet e institucioneve kompetente për identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave (qendrat për punë sociale, Mekanizmi Nacional për Referim pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale),
- t'i siguroj mbështetje fëmijës në shkollë,
- ta përfshijë në procesin mësimor, nëse ka pasur ndërprerje të shkollimit,
- ta mbështes riintegrimin e fëmijës në sistemin arsimor,
- ta ndihmojë fëmijën që t'i tejkaloj traumat e përjetuara gjatë periudhës deri sa ka qenë viktimë.

Si i realizon shkolla këto aktivitete?

Për realizimin e këtyre aktiviteteve në shkollë janë të domosdoshëm hapat si vijojnë:

- përgatitja e Programit për parandalimin e nxënësve nga trafikimi i qenieve njerëzore, ose përfshirja në Programin kundër dhunës në shkollë,

- përzgjedhja e personit përgjegjës për denoncimin e viktimave potenciale të trafikimit të fëmijëve,
- zbatimi i indikatorëve të identifikimit preliminar të viktimave të trafikimit të fëmijëve,
- konsulta me të gjithë pjesëmarrësit relevant,
- njoftimi i Qendrës kompetente për Punë Sociale, prindit ose kujdestarit,
- në raste të veçanta njoftohet edhe policia (kur ekziston rreziku ndaj fëmijës),
- veprimi në kohë të duhur dhe në mënyrë efektive



Resurset e bashkësisë vendore të cilat shkolla mund t'i shfrytëzojë

Shkolla për realizimin e aktiviteteve të veta në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi i qenieve njerëzore mund t'i shfrytëzojë shërbimet e profesionistëve nga institucionet e tjera të cilat kanë njohuri specifike për trafikimin e fëmijëve.

Këto janë:

- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Mekanizmi Nacional për Referim pranë kësaj Ministrie,
- qendrat për punë sociale,
- policia,
- Qendra për Viktimat e Trafikimit të Qenieve Njerëzore,
- Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare,
- Profesionistë nga profesione të tjera, psikologë, pedagogë,
- vullnetarë.

Kreu 5

Roli i mësimdhënësve dhe i bashkëpunëtorëve profesionistë në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të fëmijëve

Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionistë, si edhe sistemi arsimor në tërësi, janë aleatë shumë të rëndësishëm në mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi i qenieve njerëzore. Aftësia e tyre që t'i identifikojnë fëmijët viktimë potenciale të TQNj nëpër shkolla ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe për sigurinë e fëmijëve dhe për luftën e suksesshme kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Çka duhet të bëjë mësimdhënësi kur ekziston dyshimi se fëmija është viktimë e mundshme e trafikimit të fëmijëve?

Mësimdhënësi, duke e monitoruar dukurinë e indikatorëve/treguesve të caktuar tek fëmija, kur do të dyshojë se ekzistojnë indicie të rrezikut që fëmija të bëhet viktimë potenciale, apo është viktimë potenciale e të TQNj, atëherë e ka për detyrë t'i ndër marraktivitetet si vijon:

- mësimdhënësi e inkurajon dhe forcon fëmijën gjatë përvetësimit të obligimeve shkollore,
- mësimdhënësi e ambienton fëmijën në klasë, në grupin e moshatarëve,
- komunikimin me fëmijën ia përshtat moshës së tij dhe nevojave të tij,
- në mënyrë të qartë ia bën me dije fëmijës se i beson,
- e pranon përvojën e tij, sido qoftë ajo, duke ia bërë me dije se një gjë e këtitillë u ndodh edhe të tjerëve,
- nuk e gjykon fëmijën, nuk e moralizon.

Bashkëpunëtori profesionist (personi përgjegjës) i ndërmerr hapat si vijon:

- e informon fëmijën për hapat e mëtutjeshëm të cilat do t'i ndërmerr shkolla, kush do të përfshihet, kur do të njoftohet, për çka do të përdoren informacionet,
- përfshin profesionistë në mbështetjen e fëmijës, pavarësisht nëse bëhet fjalë për arsimtarë tjetër, bashkëpunëtor profesionist, profesionistë jashtë shkollës,
- vazhdimisht konsultohet me Qendrën për Punë Sociale, Qendrën e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore, me prindërit,

- reagon edhe atëherë kur sistemet e tjerë dështojnë, nuk reagojnë menjëherë ose reagojnë me vonesë,
- bashkëpunëtori profesionist vazhdimisht i ofron ndihmë fëmijës gjatë gjithë procesit.

Intervistimi i fëmijës i cili është viktimë potenciale e TQNj

Pasi që mësimdhënësi do të shfaq dyshime se një fëmijë është viktimë potenciale e TQNj, në mënyrë që ta konfirmoj ose ta hedhë poshtë dyshimin, e ka për detyrë t'u drejtohet bashkëpunëtorëve profesionistë (personit të trajnuar për zhvillimin e intervistës me fëmijë) për realizimin e intervistës me fëmijën.

Qëllimet e intervistimit

Qëllimi themelor: Vlerësimi i dyshimit se a është fëmija viktimë potenciale e trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtja e fëmijës.

Qëllime konkrete: Grumbullimi i informacioneve në lidhje me fëmijën, a ka familje, ngjarjet që i ka përjetuar, nevojat e fëmijës.

Përgatitjet për intervistimin e fëmijës viktimë e trafikimit të fëmijëve:

- intervista duhet të realizohet sa më shpejtë që është e mundshme pas shfaqjes së dyshimit se fëmija është viktimë potenciale e trafikimit të fëmijëve;
- ta realizojë personi i trajnuar për zhvillimin e intervistës me fëmijë;
- intervista duhet t'i përshtatet moshës, fazës zhvillimore, gjendjes shëndetësore dhe psikofizike të fëmijës dhe nevojave themelore të fëmijës për ujë, ushqim.

Rregullat gjatë intervistimit të fëmijës:

- informoni fëmijën në lidhje me qëllimet e intervistimit;
- njoftohuni më mirë me fëmijën, me karakteristikat dhe problemet e tij, ku jeton, a ka familje, me kë jeton, situata sociale e familjes;
- gjendja emocionale e fëmijës: a manifeston shenja të anksozitetit, frikës së tepruar, depresionit;
- cilin lloj të abuzimit e ka përjetuar: fizik, emocional, psikologjik, abuzim në punë, dhunë seksuale;
- dëgjoni me kujdes;
- vëzhgoni shenjat – gjestikulacionet e tij joverbale;
- manifestoni empati;
- mbani distancë përkatëse;
- përqendrohuni në bisedë;
- stimuloni bisedë kur fëmija heshtë;

- bëhuni të kujdesshëm, mos e detyroni të bisedojë;
- konfirmoni se fëmija pajtohet të intervistohet (nëse refuzon, nuk guxon të detyrohet);
- mos sugjeroni përgjigje;
- gradualisht kaloni nga çështja e përgjithshme në ndonjë çështje konkrete në lidhje me atë që i ka ndodhur fëmijës;
- parashtroni pyetje për ngjarje konkrete (p.sh., dëgjova se sapo je kthyer nga... a do të më tregosh se çka të ka ndodhur atje; ose: a mundesh të...);
- parashtroni pyetje konkrete të tipit: “çka”, “ku”, “kush”, “kur”, “pse”, me ç’rast mund të nxirrni më shumë detaje;
- pyetje të hapura të tipit: Kush ishte atje? Ku ishte ti kur ndodhi ajo? Kush të lëndoi?
- Pyetje të mbyllura (pyetje të cilat kërkojnë përgjigje me “po” ose “jo”. A të goditi? A ndodhte shpesh një gjë e këtillë?)

Aftësitë e nevojshme të intervistuesit

- përvojë në zhvillimin e intervistave;
- durim dhe fleksibilitet;
- aftësi monitorimi (identifikimi i hershëm i shenjave siç janë: shqetësimi, vuajtja, hidhërimi; qarje; gjuha e trupit).

Vulnerabiliteti i fëmijëve viktimë potenciale të trafikimit të qenieve njerëzore nga mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionistë kërkon kujdes të madh dhe kufizimin e aktiviteteve të caktuara të cilat mësimdhënësit dhe punonjësit e tjerë në shkollë nuk guxojnë t’i ndërmarrin me nxënësin viktimë potenciale e trafikimit të qenieve njerëzore.

Në mesin e tyre, themelore janë:

- të tregohet se nuk i beson fëmijës,
- të mos manifestohen emocione ose të manifestojnë emocione të forta,
- të gjykohet dhe kritikohet fëmija,
- të mos informohet personi përgjegjës në shkollë,
- drejtori të mos i informoj institucionet kryesore në afatin më të shkurtër (menjëherë pas pranimit të raportit),
- të tërhiqet, kur institucionet e tjera nuk reagojnë menjëherë.

Kreu 6

Procedurat e denoncimit të rastit kur ekziston dyshimi se ekziston viktimë potenciale e trafikimit të fëmijëve

Detyrimet themelore të shkollës gjatë zbulimit dhe referimit të viktimave potenciale të trafikimit të qenieve njerëzore janë:

- identifikimi preliminar i nxënësve viktimë potenciale të trafikimit të fëmijëve;
- bashkëpunimi me institucionet dhe autoritetet kompetente për identifikimin dhe mbështetjen e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, siç është Qendra për Punë Sociale dhe policia;
- sigurimi i mbështetjes së fëmijës në shkollë, përfshirja në procesin arsimor, nëse ai e ka ndërprerë shkollimin, dhe mbështetja e integritetit të tij në sistemin arsimor.

Nëse mësimdhënësi e vëren prezencën e ndonjërit të treguesve/indikatoreve se ndonjë fëmijë është viktimë potenciale e trafikimit të fëmijëve, atëherë procedura e njoftimit dhe referimit doemos duhet të ndiqet.

Denoncimi i rastit dhe referimi

Në rastet kur mësimdhënësi ose punonjësit e tjerë në shkollë tek fëmija do të vërejnë shenja ndryshimi në të nxënësit, të sjelljes dhe gjendjes shëndetësore, të cilat mund të shkaktojnë dyshime se nxënësi, sipas një numri të caktuar të indikatorëve, është viktimë potenciale e trafikimit të fëmijëve, menjëherë duhet ta informojnë personin përgjegjës, i cili pastaj e informon drejtorin e shkollës.

Ku paraqitet rasti:

1. Personi përgjegjës për denoncimin e nxënësit viktimë potenciale e TQNJ e njofton drejtorin. Drejtori ose personi përgjegjës rastin e paraqet në Qendrën për Punë Sociale, të cilët janë përgjegjës për identifikimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Nëse fëmija është identifikuar si viktimë e trafikimit të fëmijëve, atëherë Qendra për Punë Sociale rastin e paraqet në Mekanizmin Nacional për Referim (MNR). Nëse nevojitet intervenim urgjent, atëherë rasti paraqitet edhe në polici.

2. Në mënyrë plotësuese në formë të shkruar njoftohen dhe dërgohen të gjitha faktet dhe rrethanat në dispozicion, nëse i posedon, deri te Qendra kompetente për Punë Sociale dhe policia. Këto institucione pastaj ndërmarrin veprime për identifikimin e viktimës së TQNj dhe referimin dhe mbrojtjen e mëtutjeshme të viktimës.
3. Menjëherë njoftohen prindërit/kujdestarët e fëmijës/nxënësit, nëse nuk janë përfshirë në rastin, për ndryshimet e zbuluara në sjelljen e fëmijës si dhe për veprimet e ndërmarra ndaj institucioneve përkatëse.
4. Pas denoncimit të dyshimit për trafikim të fëmijëve, personi përgjegjës i shkollës duhet të hartojë shënime zyrtare, si vijon: për bisedat e zhvilluara / shkresat me personat dhe institucionet përgjegjëse për deklaratat e dhëna dhe të pranuar nga personat dhe institucionet kompetente si dhe nga persona të tjerë që kanë të bëjnë me rastin evident si dhe me çdo gjë tjetër në lidhje me informacionet plotësuese.
5. Me përkushtim bashkëpunohet me ekipin profesionist të Qendrës për Punë Sociale dhe merret pjesë në hartimin e planit dhe programit individual për mbrojtjen e fëmijës.
6. Për të gjitha gjendjet e konstatuara dhe aktivitetet e ndërmarra, institucionet kompetente (shkolla, personi përgjegjës, Qendra për Punë Social dhe policia) informohen midis tyre, dhe marrin pjesë në procedimin e mëtutjeshëm konform planit dhe programit individual për trajtimin e fëmijës të cilin e harton Qendra për Punë Sociale.
7. Me kërkesë të prokurorisë ose policisë, institucioni arsimor menjëherë ua dërgon dokumentacionin e nevojshëm integral që ka të bëjë me rastin e evidentuar me qëllim të zgjidhjes së shpejtë dhe efkase gjyqësore të të njëjtit.

Procedura duhet të jetë e shpejtë, e besueshme dhe në drejtim të mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës.

Është me rëndësi të theksohet se çdo dyshim duhet të paraqitet deri te përgjegjësit për identifikimin e fëmijëve viktimë të trafikimit të fëmijëve-Qendra për Punë Sociale.

Kreu 7

Kontaktet e mekanizmit për mbrojtjen e fëmijëve

Emërtimi i institucionit	Kontakti
Komisioni Nacional për Luftë Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migracionit Illegal – Sekretariati pranë Komisionit Nacional	tel.: (02) 3143-343; (02) 3238-595; 072/257-225
MPB – Njësia Nationale për Luftimin e Kontrabandës së Migrantëve dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore	tel.: (02) 3142 377; 070 383 896
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale – Mekanizmi Nacional për Referim	tel.: 076 456 795; 075 311 726

Mbrojtja e fëmijëve është rregulluar me aktet normative si vijon:

- Kodi Penal: Trafikimi i fëmijëve – 418g
- Ligji për marrëdhënie pune – parashikon mbrojtje të veçantë të punëtorëve të cilët nuk kanë mbushur 18 vjet
- Ligji për familjen,
- Ligji për drejtësi për fëmijën
- Ligji për mbrojtjen e fëmijëve
- Udhëzimet për procedurën e denoncimit dhe mbrojtjes së nxënësit viktimë e cilësdo qoftë formë të dhunës, abuzimit dhe shpërfilljes

Ankesi: Studimi i rastit

Studimi 1:

Darko është një fëmijë pa prindër, ka 11 vjet. Mëson në shkollën lokale dhe është nxënës i mirë. Kujdestare është tezza e tij e cila jeton me djalin jashtëmartesor në moshë prej 15 vjet. Tezja nuk punon asgjë, merr ndihmë sociale dhe jeton në një paralogje në kushte substandarde. Rrallëherë është në shtëpi ndërsa fëmijët vazhdimisht janë të uritur. Tezja shoqërohet me persona të dyshimtë, ndërsa djali i saj, i cili e braktisi shkollën, bën vjedhje të imta dhe vazhdimisht ka para. Një ditë, tezja i është ankuar një miku se e ka vështirë me fëmijët. Ai i propozoi që t'u gjej punë nga e cila edhe ajo edhe ai do të kenë benefite.

Tezja është dakordësuar menjëherë, dhe nuk ka pyetur për çfarë pune bëhet fjalë. Të nesërmen miku i saj ka shkuar në shtëpinë e tyre me automobil dhe i ka marrë fëmijët. I ka çuar larg në një fshat tek një miku i tij i cili posedon fermë të lopëve. Ai nga pronari ka marrë nga 300 euro për fëmijët. Kanë rënë dakord t'i paguaj çdo muaj nga 100 euro. Miku ia dorëzoi fëmijët, i mori paratë dhe është larguar.

Një pjesë të parave miku ia ka dhënë tezes dhe i ka thënë se çdo muaj do t'i jap nga 50 euro. Darko i tregoi pronarit se ai është në shkollë dhe nuk është paraqitur në shkollë që t'u tregoj se do të mungojë. Pronari i ka thënë se do ta regjistroj në shkollën e fshatit ku do ta vazhdoj mësimin. Por një gjë e këtillë nuk ka ndodhur.

Fëmijët punonin punë të rënda, e kanë pastruar stallën, kanë punuar në fushë, i kanë kullotur lopët, ndërsa në shtëpi janë kthyer vonë. Gjatë gjithë ditës kanë ngrënë ushqim të thatë, ndërsa në mbrëmje darkë të varfër. Pronari nuk ka qenë i vrazhdë me ata, por ka qenë i rreptë dhe i ka kontrolluar si dhe sa punojnë. Fëmijët nuk kanë kontaktuar me persona të tjerë përveç pronarit. Nuk kanë marrë para për punën e tyre.

Darko vazhdimisht ka pyetur se kur do të kthehet që ta vazhdoj shkollimin, por përgjigjja çdoherë ka qenë – së shpejti.

Mësimdhënësja, disa herë ka bërë përpjekje ta kërkoj Darko-n, por nuk ka mund ta gjejë tezen. Një ditë e takoi tezen dhe e ka pyetur për Darkon, ajo u përgjigj se e ka braktisur dhe nuk e din ku ndodhet. Rasti u zbulua gjatë vizitës në terren dhe gjatë inspektimit të ekipit profesionist të Qendrës Ndërkomunale për Punë Sociale.

Pyetje:

1. A është Darko viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore?
2. Nëse PO, atëherë për cilin lloj të trafikimit të fëmijëve (lloji i eksploatimit) bëhet fjalë?
3. Theksoni treguesit/indiktorët sipas të cilëve konkluduar për llojin e trafikimit të fëmijëve lloji i eksploatimit).
4. A mund të bëjë mësimdhënësi diçka më shumë që ta ndihmojë Darkon?

Sqaroni:

Studimi 2:

Suzana është 13 vjeçare. Vjen nga një familje e varfër. Shkon në shkollë por nuk është e rregullt. Tanimë 1,5 muaj nuk shkon në shkollë dhe për këtë askush nuk jep kurrfarë arsytimi. Familja e saj nuk u përgjigjet thirrjeve nga shkolla. Pedagogu i shkollës, pasi që nuk ka pranuar përgjigje nga familja në lidhje me atë se ku është Suzana, ka biseduar me shoqet e saj të cilat i kanë treguar se paskan dëgjuar se ka mundësi të punojë në ndonjë kafene në ndonjë fshat të Tetovës.

Pedagogu rastin e ka paraqitur në QPS, si dhe ua ka dërguar informacionin se Suzana ka mundësi që të gjendet në ndonjë objekt hotelerie në ndonjë fshat të Tetovës. Punëtori social këtë informacion ia ka dërguar MPB.

Suzanën e gjetën gjatë kontrollit policor në kafene.

Në një bisedë preliminare, ajo ka thënë se babai i saj ka organizuar / është marrë vesh përmes një miku të tij që të punojë. Një person i panjohur me automobil e ka transportuar deri te kafeneja. Prej atëherë e ka pasur të ndaluar të dal nga objekti. Babait të saj i është premtuar se do të marrë nga 50 euro në muaj.

1. A është Suzana viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore?
2. Nëse PO, atëherë për cilin lloj të trafikimit të fëmijëve (lloji i eksploatimit) bëhet fjalë?
3. Theksoni indikatorët sipas të cilëve konkluduar për llojin e trafikimit të fëmijëve (lloji i eksploatimit).
4. Cilat veprime ka mundur t'i ndër marrë shkolla?

Sqaroni:

Ky Manual u dedikohet mësimdhënësve dhe kuadrit tjetër arsimor të cilët mund të kenë kontakt me fëmijën viktimë potenciale e trafikimit të qenieve njerëzore. Manuali ofron informacione lidhur me trafikimin e fëmijëve, duke i përfshirë edhe treguesit/indiktorët e identifikimit të fëmijëve viktimë potenciale dhe ofron sqarime si të mbrohen dhe referohen deri te institucionet kompetente. Në këtë mënyrë, shkollat janë më mirë të përgatitura ta luajnë rolin sa i përket parandalimit dhe mbrojtjes së fëmijëve viktimë potenciale të trafikimit të fëmijëve në aksionin e përgjithshëm të drejtuar kundër trafikimit të fëmijëve në Maqedoninë e Veriut.

Analiza e situatës në Maqedoninë e veriut e vuri në dukje se numri i fëmijëve viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore në krahasim me viktimat e moshës madhore shënon rritje. Sipas institucioneve kompetente dhe shoqatave qytetare, shumica e viktimave të identifikuar të trafikimit të qenieve njerëzore janë fëmijë - katër nga gjashtë viktimat të identifikuar në vitin 2020 ishin fëmijë, ndërsa numri është rritur në vitin 2020 në gjashtë fëmijë nga gjithsej shtatë viktimat të identifikuar.

Mësimdhënësit në shkollat fillore dhe profesorët në shkollat e mesme, psikologët dhe pedagogët e kanë rolin kryesor në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të fëmijëve përmes identifikimit proaktiv, mbrojtjes dhe referimit të fëmijëve viktimë potenciale të trafikimit të fëmijëve. Manuali synon t'u dalë në ndihmë në mënyrë që rolin e tyre ta kryejnë me efikasitet dhe duke i respektuar viktimat.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës pale.

Këshilli i Evropës është organizatë prijëse e të drejtave të njeriut në Evropë. Përbëhet nga 47 vende anëtare, duke i përfshirë të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës e kanë nënshkruar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, marrëveshje e dedikuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të së drejtës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e monitoron implementimin e Konventës në vendet anëtare.

www.coe.int

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian vendosën t'i gërshetojnë njohuritë, mjetet dhe fatet e tyre. Bashkë, e ndërtuan hapësirën e stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, së këtejmi duke e ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë e individit. Bashkimi Evropian është i përkushtuar në ndarjen e arritjeve dhe vlerave të tij me vendet dhe njerëzit jashtë kufijve të tij.

www.europa.eu

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



MINISTERTHO DOKUMENTIMARE E HETAJE-SHËRIMIPUNËNIA SHËRIMIKOMUNIKIMET
MINISTRE DOKUMENTIMARE E HETAJE-SHËRIMIPUNËNIA SHËRIMIKOMUNIKIMET
MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE-AGENCY FOR DEVELOPMENT OF EDUCATION